

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Pkl-Kzz. Nr. 74/2009**  
**6 korrik 2009**  
**Prishtinë**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Kryetari Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it dhe gjyqtar raportues, Gianfranco Gallo, gjyqtar i EULEX-it, Agim Krasniqi, Tahir Recaj dhe Gjuran Dema, të gjithë gjyqtarë të Gjykatës Supreme dhe anëtarë të kolegjit;

Të ndihmuar nga Judit Eva Tatrai, zyrtare ligjore e EULEX-it, procesmbajtëse, Naser Syla dhe Mentor Osmani, përkthyes të EULEX-it;

Në lëndën penale kundër *V.A.*, *et alia*, të akuzuar me vepër penale të Rrëmbimit në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 23 dhe 159, paragrin (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK);

Duke vendosur lidhur me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për të pandehurin *V.A.*, të paraqitur përmes Avokatit të tij mbrojtës *N.L.* kundër Aktvendimit P. Nr. 570/07, të datës 27 maj 2009, të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, mbi caktimin e masës së paraburgimit kundër të akuzuarit dhe kundër Aktvendimit Pn.-Kr. Nr. 226/2009, të datës 4 qershor 2009, të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbi refuzimin e ankesës së të pandehurit të paraqitur kundër aktvendimit të lartpërmendur;

Pas rishikimit të shënimave të gjykatës, kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe mendimit të Prokurorisë Publike, dhe pas analizimit të ligjeve përkatëse;

Në përputhje me nenin 456 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në dobi të *V.A.*, më datën 8 qershor 2009, kundër Aktvendimit P. Nr. 570/07, të datës 27 maj 2009, të kolegit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, mbi caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit dhe kundër Aktvendimit Pn.-Kr. Nr. 226/2009, të datës 4 qershor 2009, të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbi refuzimin e ankesës së të pandehurit të paraqitur kundër aktvendimit të siperpërmendor, **REFUZOHET si e pabazë**.

### **ARSYETIM**

#### **Historia procedurale:**

Në aktgjykimin P. Nr. 57/2007 të datës 27 maj 2009, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kolegji kishte shpallur fajtor *V.A.* për veprën penale të Rrëmbimit në bashkëkryerje me tre të akuzuar të tjerë, në kundërshtim me nenin 23 dhe 159, paragrin (2) të KPK-së, dhe e ka dënuar të njëjtin me tre (3) vjet burgim. Me një aktvendim të veçantë, kolegji kishte caktuar masën e paraburgimit kundër *V.A.*, sipas nenit 281, paragrafit (1), nënparagrafit (2), pikës (i), ngase rrethanat tregonin përrrezikun e arratisjes.

Ankesa e paraqitur nga i pandehuri kundër këtij aktvendimi është refuzuar si e pabazë nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes Aktvendimit Pn.-Kr. Nr. 226/2009, të datës 4 qershor 2009.

Më 8 qershor 2009, **V. A.** ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë përmes avokatit të tij **N. L.**, kundër dy aktvendimeve të sipërpermendura.

**Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit **V. A.** :**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit i referohet një shkeljeje thelbësore të dispozitive të kodit të procedurës penale. Më konkretisht, argumenton se gjatë caktimit të paraburgimit kundër **V. A.**, kolegji ka shkelur ligjin procedural ngase nuk ka mbështetur vendimin me argumente të vlefshme sa u përket rrëthanave që tregojnë se **V. A.** do të ikte nga Kosova me qëllim të shmangies së vuajtjes së dënit të shqiptuar kundër tij. Kërkesa po ashtu shton se pesha e dënit – tre vjet burgim – nuk ofron bazë të mjaftueshme për urdhërimin e kësaj mase kundër të pandehurit, i cili gjithmonë u është përgjigjur me kohë ftesave gjatë tërë procedurës penale dhe i cili gjithashtu ka lidhje familjare dhe punë të mirë në Kosovë. Aktvendimit gjithashtu i mungon arsyetimi lidhur me pamjaftueshmërinë e masave të tjera të sigurisë përvëç paraburgimit. Në fund, kërkesa përsërit faktin se masa kundër të pandehurit është caktuar pa kërkuar mendimin e prokurorit publik. Sipas kërkesës, të njëjtat shkelje mund të identifikohen edhe në aktvendimin e Gjykatës Supreme, e cila kishte refuzuar kërkesën e të pandehurit kundër aktvendimit të trupit gjykues.

Prokuroria publike, në mendimin e saj të paraqitur më 12 qershor 2009, ka argumentuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit **V. A.** është e pabazë dhe ka propozuar refuzimin e saj.

**Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës:**

Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës vëren se, për dallim nga kërkesa e të pandehurit për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjatë caktimit të masës së paraburgimit kundër **V. A.** pa dëgjuar mendimin e prokurorit publik, kolegji nuk ka shkelur dispozitat e nenit 393, paragrafit (4) të KPPK-së në atë masë që do të ndikonte në ligjshmërinë e Aktvendimit të tyre.

Përkitazi me rrëthanat e rastit që tregojnë rrezikun e arratisjes së të pandehurit **V. A.**, Gjykata Supreme e Kosovës shton se përvëç argumenteve mbështetëse të përcaktuara në aktvendimet e kaluara, *modus operandi* i veprës penale për të cilën është dënuar **V. A.**, pastaj natyra poroze e kufijve të Kosovës dhe kohëzgjatja e burgimit me të cilën do të ballafaqohet **V. A.** po qe se aktgjykimi bëhet i formës së prerë, shpie në konstatimin se po qe se lirohet i pandehuri, ai do të arratisej nga Kosova me qëllim të shmangies së ekzekutimit të dënit.

Për këto arsy, Gjykata Supreme konstaton se një masë më e-butë nuk do të ishte e mjaftueshme për eliminimin e rrezikut të arratisjes së të pandehurit.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto arsyet, vendoset si në Dispositivin e këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Pkl.-Kzz. Nr. 74/2009**  
**6 korrik 2009**

**Anëtarët e kolegit:**

---

**Gianfranco Gallo**  
**Gjyqtar i EULEX-it**

---

**Agim Krasniqi**  
**Gjyqtar i Gjykatës Supreme**

---

**Tahir Recaj**  
**Gjyqtar i Gjykatës Supreme**

---

**Gjuran Dema**  
**Gjyqtar i Gjykatës Supreme**


**Kryetar i kolegit:**

---

**Guy Van Craen**  
**Gjyqtar i EULEX-it**

---

**Judit Eva Tatrai**  
**Zyrtare ligjore e EULEX-it**



Republika e Kosovës  
SAKTÉSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAÇNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE



Punëtori i autorizuar  
Ovlašcenii radnik